

1. Titulli i lëndës: PREZANTIM DHE MODERIM

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Prezantim dhe moderim
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i I-rë , Semestri I I-rë
Numri i orëve në javë:	2 +2
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Mësimdhënësi: Dr. Dren Gërguri
Të dhënat kontaktuese:	dren.gerguri@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda 'Prezantim dhe moderim' ofron njohuri themelore dhe praktike për prezantimin dhe moderimin në media, me fokus të veçantë në gazetarinë televizive. Studentët do të mësojnë për teknikat e të folurit para kamerës, përgatitjen e skenarëve, strukturën e edicionit informativ, si dhe ndërtimin e prezencës profesionale në ekran. Në kuadër të kësaj lënde, do të zhvillohen edhe ushtrime praktike në studio televizive, duke simuluar prezantime lajmesh, moderim debatesh dhe emisione informative.
Qëllimet e lëndës:	- Të zhvillojë aftësitë prezantuese dhe të komunikimit verbal dhe joverbal në media. - T'i pajisë studentët me njohuri për format dhe stilin e moderimit në televizione. - Të forcojë besimin në të folurën para publikut dhe kamerës. - Të aftësojë studentët për përgatitje dhe drejtim të emisioneve televizive.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: - Prezantojnë me siguri dhe qartësi përmbajtje në format televiziv; - Përdorin teknika të duhura të të folurit, artikulimit dhe prezencës në kamerë; - Përgatisin skenarë për edicione informative apo

		emisione të formateve të ndryshme; - Drejtojnë debate dhe emisione duke ruajtur neutralitetin dhe rrjedhën profesionale.	
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2 (90min)	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	5	2	10
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	5	10
Përgatitja për provimin final	5	3	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			103.5 orë
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata teorike, ushtime praktike në studio televizive, analiza e prezantimeve reale, diskutime interaktive dhe simulime të drejtimit të emisioneve.		
Metodat e vlerësimit:	10% Pjesëmarrja 10 % Test intermediar 20% Ushtimet 25% Punë praktike 35% Provimi final		
Literatura primare:	- Thompson, R. (2011). Writing and Producing Television News. Focal Press. - Stewart, P. et al. (2008). Broadcast Journalism: Techniques of Radio and Television News. Focal Press. - Boyd, A. (2001). Broadcast Journalism: Basic Guide to Reporting and Production. Butterworth-Heinemann. - Russ-Mohl, S. et al. (2024). Gazetaria. Albas..		
Literatura shtesë:	- Burgoon, J.K., Guerrero, L.K., & Floyd, K. (2016). Nonverbal Communication. Routledge. - Ekman, P. (2009). Telling Lies: Clues to Deceit in the Marketplace, Politics, and Marriage. Norton.		

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1	Hyrje në lëndë dhe konceptet bazë të prezantimit
Java 2	Prezantimi në media – veçoritë dhe rëndësia
Java 3	Gjuha verbale dhe joverbale në paraqitjen televizive
Java 4	Struktura e një emisioni informativ
Java 5	Artikulimi dhe teknikat e të folurit të qartë
Java 6	Stili personal i prezantuesit
Java 7	Praktikë në studio – leximi i lajmeve
Java 8	Moderimi i debatit televiziv
Java 9	Java e testit intermediar
Java 10	Analiza e prezantimeve të njohura televizive
Java 11	Zhvillimi i skenarit për emision
Java 12	Prezantimi në situata të papritura
Java 13	Simulim i drejtimit të emisioneve live
Java 14	Vlerësimi dhe përmirësimi i performancës
Java 15	Përmbledhje dhe përgatitje për provim final
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes	
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: Zbatohen politikat dhe rregullat e përgjithshme të Fakultetit të Filologjisë për integritetin akademik dhe sjelljen e studentëve.	